



Funded by
the European Union

Drejt një të ardhmeje më të gjelbër: Themelimi i Fondit të Gjelbër për Kosovën

Përmbledhje e politikave #2

Maj 2025

Autorët:

Prof. Dr. Besnik A. Krasniqi, Ekspert i Ekonomisë Qarkore

Dr. Albana Rexha, Eksperte për Integrimin e Perspektivës Gjinore

Urim Xharavina, Rilindja Gjelbër

Lendita Kastrati, People in Need Kosovo

Mohimi i përgjegjësisë:

Ky publikim është prodhuar si pjesë e projektit “CE4GR - Ekonomia Qarkore për Tranzicion të Gjelbër në Kosovë”, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe i implementuar nga People in Need dhe Rilindja Gjelbër. Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë ato të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Përmbledhje

Procesi i përcaktimit të taksave mjedisore është një instrument i rëndësishëm fiskal që përdoret nga qeveritë për të gjeneruar të ardhura me qëllim zbutjen e ndikimeve mjedisore dhe promovimin e qëndrueshmërisë. Në Kosovë, këto taksa përbëjnë një burim të rëndësishëm të të ardhurave. Megjithatë, ekziston një mospërputhje e qartë mes të ardhurave të arkëtuara dhe shumës së shpenzuar për mbrojtjen e mjedisit. Kosova mbledh të ardhura të konsiderueshme nga taksat mjedisore - të vlerësuara rreth 2.3% të BPV-së - por alokon më pak se 2% të këtyre fondeve për mbrojtjen e mjedisit. Kjo mospërputhje minon efektivitetin dhe besueshmërinë publike të procesit të përcaktimit të taksave të gjelbra, ndërkohë që sfida urgjente si ndotja e ajrit, sistemet joeficiente të mbeturinave dhe cenueshmëria ndaj klimës mbesin të pafinancuara.

Kjo përmbledhje e politikave bën thirrje për krijimin e një Fondi të Gjelbër për Kosovën - një mekanizëm i dedikuar dhe transparent financimi që do të riinvestonte një pjesë domethënëse të të hyrave nga taksat mjedisore në iniciativa strategjike për qëndrueshmëri. I modeluar sipas praktikave më të mira rajonale si Eko Sklad në Slloveni, Fondi i Gjelbër i propozuar do të mbështeste investimet në energji të ripërtëritshme, eficiencë të energjisë, cilësi të ajrit, biodiversitet dhe ekonominë qarkore.

Fondi do të shërbente si mjet për përmirësimin e qeverisjes fiskale, ndërtimin e besimit publik, mobilizimin e financimit të përbashkët ndërkombëtar dhe sigurimin e përafrimit të Kosovës me Agjendën e Gjelbër të BE-së. Duke lidhur arkëtimin e të ardhurave me shpenzimet e synuara të gjelbra, Kosova mund të përshpejtojë tranzicionin mjedisor, të stimulojë punësimin e gjelbër dhe të kontribuojë në qëndrueshmërinë afatgjatë ekonomike.

Për të siguruar që të hyrat nga taksat mjedisore në Kosovë të riinvestohen në mënyrë efektive në qëndrueshmëri dhe zhvillim të gjelbër, kjo përmbledhje e politikave rekomandon veprimet e mëposhtme:

- Themelimin e Fondit të Gjelbër me mandat ligjor, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Ambientit, i dedikuar për financimin e iniciativave të ekonomisë qarkore, mbrojtjen e mjedisit, veprimet klimatike dhe reduktimin e ndotjes së ajrit.

Fondi i Gjelbër duhet të:

- Ketë një strukturë të pavarur qeverisëse me mekanizma transparentë të mbikëqyrjes.
- Sigurojë përfaqësim të balancuar gjinor në bord dhe në organet vendimmarrëse.
- Ndajë një minimum prej 30% të të gjitha të hyrave të mbledhura nga taksat mjedisore drejtpërdrejt në Fondin e Gjelbër, duke garantuar një rrjedhë financiare të parashikueshme dhe të përgjegjshme për iniciativat e gjelbra.

Fondi i Gjelbër do të:

- Promovojë dhe ndikojë pozitivisht në mbrojtjen e mjedisit.
- Mbështesë dhe nxisë iniciativat e ekonomisë qarkore.
- Rrisë ndërgjegjësimin për praktikën e qëndrueshmërisë.
- Forcojë përfshirjen e grave dhe grupeve të marginalizuara në zhvillimin e biznesit të gjelbër.
- Rrisë pjesëmarrjen e grave në mundësitë e financimit publik.

Pse duhet të themelohet Fond i Gjelbër në Kosovë?

Në Kosovë, vazhdon të ekzistojë një hendek kritik mesh mbledhjes së tatimeve mjedisore dhe financimit të iniciativave për mbrojtjen e mjedisit. Edhe pse taksimi mjedisor gjeneron rreth 2.3% të BPV-së në vit, afërsisht 240 milionë euro, më pak se 2% e këtyre të hyrave riinvestohen në prioritetet mjedisore. Në vend të kësaj, pjesa më e madhe e të ardhurave nga tatimet mjedisore absorbohen në buxhetin e përgjithshëm, duke rezultuar në financim të kufizuar për çështjet urgjente siç janë ndotja e ajrit, menaxhimi i mbeturinave, zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike.

Themelimi i Fondit të Gjelbër do të siguronte që një pjesë e konsiderueshme e të hyrave nga taksat mjedisore të alokohen sistematikisht për mbrojtjen e mjedisit, në vend që të shpërndahet në shpenzime të përgjithshme. Duke i kanalizuar burimet në projekte të gjelbra me prioritet të lartë, Fondi do të përshpejtonte progresin e Kosovës në adresimin e sfidave kritike mjedisore dhe do të kontribuonte në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Barazia gjinore është thelbësore për suksesin e tranzicionit mjedisor të Kosovës. Gratë, veçanërisht në komunitetet rurale dhe të marginalizuara, preken në mënyrë disproporcionale nga degradimi mjedisor, por mbeten të nënpërfaqësuar si në proceset vendimarrëse ashtu edhe në sektorët e punësimit të gjelbër. Integrimi i perspektivës gjinore në projektimin dhe zbatimin e Fondit të Gjelbër do të siguronte që gratë të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga investimet klimatike dhe të përfshihen aktivisht në kalimin drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjithashtu, krijimi i Fondit të Gjelbër do të ndihmonte në forcimin e besimit publik në procesin e tatimit mjedisor duke siguruar menaxhim dhe raportim transparent të të hyrave dhe shpenzimeve. Kjo do të rrisë besimin e qytetarëve, do të inkurajonte përputhshmërinë më të madhe me tatimet dhe do të tregonte angazhimin e qeverisë për llogaridhënie dhe politikë fiskale të përgjegjshme.

Nga perspektiva strategjike, themelimi i Fondit të Gjelbër është thelbësor për përafrimin e politikave mjedisore të Kosovës me Agjendën e Gjelbër të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor. Kosova është zotuar për Agjendën e Gjelbër dhe ka miratuar disa dokumente strategjike.

Një vizion afatgjatë për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit është artikuluar në Programin Kombëtar për Zhvillim 2030¹. Dokumentet tjera kryesore përfshijnë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), Programin e Reformave Ekonomike dhe Udhëzuesin e fundit të miratuar për Ekonominë Qarkore. Udhëzuesi për Ekonominë Qarkore për Kosovën përfaqëson një pikë kthese të rëndësishme në tranzicionin e vendit drejt ekonomisë qarkore. Ai vendos bazën për një kuptim më të mirë të forcave, kapaciteteve dhe mundësive unike të Kosovës që mund të nxisin një transformim të suksesshëm qarkor. Këto dokumente strategjike të miratuara nga Qeveria e Kosovës (QK) janë në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Agjendën e Integritimit Evropian². Qeveria e Kosovës ka theksuar se zbatimi i këtyre objektivave do të realizohet përmes strategjive sektoriale dhe planeve institucionale të veprimit, të shoqëruara me mekanizma mbikëqyrës për të siguruar përputhshmërinë me buxhetin shtetëror. Më konkretisht, objektivat e përcaktuara në SKZH do të operacionalizohen përmes objektivave strategjike në strategjitë sektoriale, të cilat më pas do të përkthehen në aktivitete konkrete me kode buxhetore të paracaktuara, duke siguruar llogaridhënie dhe qartësi në shpenzimet publike.

Për më tepër, urgjenca për të adresuar boshllëkun financiar theksohet në Raportin e Progresit për Kosovën 2024 të Komisionit Evropian, i cili shprehe qartë: “Kosova duhet të kryejë punë të mëtijshme për të përfshirë faktorë të qëndrueshëm si në politikat dhe objektivat strategjike bankare ashtu edhe ato jo-bankare, dhe për të zbatuar një kornizë rregullative financiare që mbështet investimet private drejt aktiviteteve të qëndrueshme/të gjelbra.” (*Raporti i Progresit për Kosovën 2024*, f. 69)³. Kjo deklaratë nxjerr në pah një dobësi thelbësore në tranzicionin e gjelbër të Kosovës: mungesën e infrastrukturës rregullatore dhe financiare që mundëson investime domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm nga sektori publik dhe ai privat.

Demonstrimi i mekanizmave të besueshëm të financimit të gjelbër jo vetëm që do ta përmirësonte pozicionin e Kosovës në proceset e anëtarësimit në BE, por edhe do të hapte mundësi për të siguruar bashkëfinancim ndërkombëtar nga BE-ja, donatorët ndërkombëtarë dhe institucionet e financimit klimatik. Pa një Fond të dedikuar të Gjelbër, Kosova rrezikon të vazhdojë një cikël ku të hyrat mjedisore arkëtohen pa dhënë rezultate konkrete mjedisore. Themelimi i Fondit të Gjelbër do të siguronte një mjet themelor për forcimin e qeverisjes mjedisore, promovimin e inovacionit të gjelbër dhe ekonomisë qarkore, krijimin e vendeve të punës të gjelbra dhe rritjen e qëndrueshmërisë së Kosovës ndaj reziqeve klimatike dhe ekologjike. Për më tepër, Fondi i Gjelbër duhet të përdorë parimet e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, duke siguruar që projektet e financuara të përfshijnë rezultate të matshme për barazinë gjinore. Udhëzimet e aplikimit duhet t’u kërkojnë aplikantëve që të tregojnë qartë se si projektet e tyre fuqizojnë gratë ose adresojnë cenueshmëritë mjedisore specifike për gjininë.

¹ Qeveria e Republikës së Kosovës, Koncepti për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030. Shiko Ligjin nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (2009). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631&langid=2>.

² Komisioni Evropian ka përkufizuar Marrëveshjen për Industri të Pastër si vazhdim i Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Do të mbështetet në punën e BE-së për të kaluar në një ekonomi të qëndrueshme dhe do të përqendrohet në forcimin e industrisë dhe rritjen e konkurrueshmërisë brenda këtij konteksti. (shih <https://www.cleanenergywire.org/factsheets/qa-eu-aims-bolster-competitiveness-through-clean-industrial-deal#:~:text=der%20Leyen%20said,-How%20is%20it%20different%20from%20the%20European%20Green%20Deal%3F,increasing%20competitiveness%20with%20this%20context>)

³ Dokument pune i personelit të komisionit (2024) Raporti për Kosovën* i vitit 2024 ([https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Raporti i Kosovës 2024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Raporti%20i%20Kosovës%202024.pdf), qasur në prill 2024)


Lidhja që mungon: Taksat dhe shpenzimet mjedisore në Kosovë

Në vitet e fundit, Kosova ka futur në përdorim një sërë taksash mjedisore që synojnë promovimin e praktikave të qëndrueshme dhe gjenerimin e të ardhurave publike për mbrojtjen e mjedisit. Këto taksa, të cilat vlerësohen të përbëjnë rreth 2.3% të BPV-së, kanë potencialin të shërbejnë si instrumente të fuqishme për të nxitur tranzicionin e gjelbër të vendit. Megjithatë, pavarësisht të ardhurave të konsiderueshme të mbledhura, mbetet një shkëputje e qartë ndërmjet procesit të taksimit mjedor dhe investimeve aktuale në iniciativat e mbrojtjes së mjedisit dhe qëndrueshmërisë. Vetëm një pjesë shumë e vogël e fondeve të mbledhura nga taksat mjedisore, më pak se 2%, është riinvestuar në masa për mbrojtjen e mjedisit. Kjo lidhje që mungon ndërmjet arkëtimit të të ardhurave dhe shpenzimeve dobëson efektivitetin e përgjithshëm të politikave mjedisore, minon besimin e publikut në tatimet e gjelbra dhe e kufizon aftësinë e Kosovës për të adresuar sfidat urgjente siç janë ndotja e ajrit, menaxhimi i mbeturinave, zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme dhe qëndrueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike. Tejkalmi i këtij hendeku është thelbësor për të siguruar që tatimi mjedor të përmbushë qëllimin e tij dhe të kontribuojë në mënyrë domethënëse në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës.

Analiza e të ardhurave nga taksat mjedisore në raport me shpenzimet e dedikuara për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë gjatë viteve 2019–2023 nxjerr në pah mospërputhje të mëdha (shih figurën 1). Pavarësisht burimeve të konsiderueshme financiare të arkëtuara, riinvestimet në aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit kanë mbetur minimale dhe kanë vazhduar të bien me kalimin e kohës.

Gjatë periudhës 2019 deri në 2023, Qeveria e Kosovës ka arkëtuar të hyra të konsiderueshme përmes taksave mjedisore, që kanë variuar çdo vit nga rreth 272.8 milionë euro deri në 340.3 milionë euro. Megjithatë, shpenzimet e alokuara posaçërisht për mbrojtjen e mjedisit nuk e kanë ndjekur këtë trend. Në vitin 2019, për shembull, vetëm 23.7 milionë euro u shpenzuan për mbrojtjen e mjedisit nga 287.9 milionë euro të arkëtuara. Kjo mospërputhje u thellua në vitet në vijim, ku shpenzimet ranë në 14.8 milionë euro në vitin 2020, 9.5 milionë euro në vitin 2021 dhe vetëm 7.9 milionë euro në të dy vitet 2022 dhe 2023, pavarësisht arkëtimit vazhdimisht të lartë të të ardhurave.

Environmental Tax Revenues vs. Environmental Protection Expenditures in Kosovo (2019–2023)




Burimi: Instituti Atlas, bazuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës 2025.

Figura e mëposhtme nxjerr në pah mospërputhjet në përqindjen e shpenzimeve qeveritare për mbrojtjen e mjedisit në krahasim me të ardhurat nga taksat mjedisore (2019–2023). Të dhënat zbulojnë një hendek shqetësues ndërmjet të ardhurave të arkëtuara përmes taksimit mjedisor dhe shpenzimeve aktuale të qeverisë për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë.

Gjatë periudhës 2019 dhe 2023, përqindja e të ardhurave nga taksat mjedisore të alokuara për mbrojtjen e mjedisit ra ndjeshëm nga 8.23% në vitin 2019 në vetëm 2.32% në vitin 2023. Kjo rënie e vazhdueshme dhe e ndjeshme pasqyron sfida serioze në qeverisje dhe menaxhim fiskal, duke ngritur shqetësime në lidhje me angazhimin e qeverisë ndaj qëndrueshmërisë mjedisore.

Pavarësisht mbledhjes së qëndrueshme dhe stabile të taksave mjedisore (vlera që vazhdimisht tejkalon 270 milionë euro çdo vit), është vërejtur një dobësim i vazhdueshëm i përkushtimit financiar për nisma mjedisore. Trendët në rënie të alokimit sinjalizojnë një mospërputhje të mundshme ndërmjet politikës buxhetore dhe objektivave mjedisore. Ky riinvestim vazhdimisht i ulët dhe në rënie në mbrojtjen e mjedisit ka të ngjarë të:

- Minojnë besimin e publikut,
- Ulë motivimin për përmbushjen e detyrimeve tatimore,
- Dëmtojnë besueshmërinë dhe efektivitetin e tatimeve mjedisore si një mjet i politikave.



Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në Institutin Atlas/Agjencia e Statistikave të Kosovës 2025.

Ky hendek i theksuar ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve tregon për joefikasitet në alokimin e burimeve, duke ngritur shqetësime lidhur me transparencën fiskale, llogaridhënien në qeverisje dhe përkushtimin e qeverisë ndaj objektivave të qëndrueshmërisë mjedisore. Gjithashtu sugjeron se qëllimi parësor i këtyre taksave për financimin e masave për mbrojtjen e mjedisit nuk po përmbushet, gjë që mund të minojë edhe më tej besimin e publikut në politikën e tatimit mjedisor.

Për të justifikuar mbledhjen e vazhdueshme të tatimeve mjedisore dhe për të rikthyer besimin e publikut, është thelbësore që Qeveria e Kosovës të sigurojë që këto të ardhura të ndahen në mënyrë transparente dhe efektive për projekte dhe iniciativa mjedisore.

Për ta arritur këtë, masat e politikave duhet të:

- Përcaktojnë qartë që të ardhurat nga tatimet mjedisore të destinohen për shpenzime në fushën e mjedisit;
- Shoqërohen me mekanizma të qartë të raportimit, monitorimit dhe auditimit për të përcjellur dhe verifikuar përdorimin efektiv të fondeve.

Për më tepër, disa projekte të financuara dhe të zbatuara nga organizatat buxhetore në Kosovë nuk janë të shënuara si “të gjelbra” në mënyrë të duhur, gjë që e vështirëson përcjelljen dhe verifikimin nëse ndarjet buxhetore janë orientuar në mënyrë efektive drejt objektivave të ekonomisë së gjelbër dhe qarkore⁴. Kjo dëmton transparencën dhe kufizon ndikimin strategjik të shpenzimeve mjedisore. Në këtë drejtim, hendeuku ndërmjet të hyrave nga tatimet mjedisore dhe investimeve faktike në projekte mjedisore duhet të merret si një sinjal paralajmërues.

Shembull nga Sllovenia: Roli i Fondit të Gjelbër në promovimin e mjedisit

Seksioni në vijim paraqet rastin e suksesshëm të përdorimit të të ardhurave nga taksat mjedisore në Slloveni për mbrojtjen e mjedisit. Në vitin 2021, Sllovenia mbledhi rreth 1.94 miliardë euro nga taksat mjedisore, që përfaqësojnë rreth 3.8% të BPV-së së saj (Eurostat, 2022). Këto të ardhura u mbledhën nga burime të ndryshme, duke përfshirë taksat mbi energjinë, regjistrimin e automjeteve, tarifat për ndotjen dhe - përdorimin e burimeve natyrore. Gjatë të njëjtit vit, Sllovenia shpenzoi rreth 510 milionë euro për masa mbrojtëse mjedisore, duke përfshirë menaxhimin e mbeturinave, ruajtjen e biodiversitetit, programet e përmirësimit të cilësisë së ajrit, promovimin e energjisë së ripërtëritshme dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (Eurostat, 2022; Ministria Sllovene e Financave, 2022).

Shkalla e riinvestimit të drejtpërdrejtë të të ardhurave nga taksat mjedisore në mbrojtjen e mjedisit është llogaritur të jetë rreth 26.29%, duke treguar se pak më shumë se një e katërta e të ardhurave nga taksat mjedisore të Sllovenisë u përdorën për objektiva mjedisore.

Ndërsa Sllovenia demonstroi një lidhje të fuqishme mes mbledhjes së taksave mjedisore dhe shpenzimeve mjedisore, është e rëndësishme të theksohet se jo të gjitha të ardhurat nga taksat mjedisore janë të destinuara posaçërisht për mbrojtjen e mjedisit (Eko Sklad, 2022). Një pjesë e të ardhurave, veçanërisht nga taksat e konsumit të energjisë dhe taksat e pronësisë së automjeteve, vazhdojnë të arkëtohen në buxhetin e përgjithshëm të shtetit për të financuar shpenzimet tjera publike.

Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme dhe e menaxhuar mirë e të ardhurave mjedisore në Slloveni ndahet përmes Fondit Mjedor (Eko Sklad, 2022). Në vitin 2021, Eko Sklad menaxhoi drejtpërdrejt rreth 100 milionë euro për projekte mjedisore, të cilat u fokusuan kryesisht në:

- Mbështetjen e përmirësimit të efikasitetit të energjisë në amvisëri dhe biznese,
- Promovimin e energjisë së ripërtëritshme, siç janë panelet solare dhe biomasa,
- Financimin e iniciativave për lëvizshmëri të qëndrueshme, duke përfshirë subvencionet për vetura elektrike dhe zhvillimin e infrastrukturës për karikimin e tyre (Eko Sklad, 2022).

Përmes funksionimit të strukturuar të Eko Sklad, Sllovenia ka siguruar që një pjesë domethënëse dhe transparente e të ardhurave mjedisore të kontribuojë drejtpërsëdrejti në objektivat e saj kombëtare për klimën dhe mjedisin. Modeli slloven tregon se edhe pa i ndarë plotësisht të gjitha të ardhurat nga taksat mjedisore, krijimi i mekanizmave financiarë të dedikuar për shpenzimet mjedisore, siç është Eko Sklad, është thelbësor. Kjo qasje garanton që të paktën një pjesë e konsiderueshme e këtyre të ardhurave mjedisore të riinvestohet në mënyrë të qartë në përmirësime mjedisore dhe objektivat e politikave publike kombëtare.

⁴ Diskutim gjatë tryezës së rrumbullakët me titull “Ekonomia Qarkore për Tranzicionin e Gjelbër në Kosovë”. 30 Maj 2025, Prishtinë, Kosovë.

Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor mund të nxjerrin mësimet të rëndësishme nga Sllovenia duke:

- Krijuar një Fond të Gjellbër që menaxhon një pjesë të dedikuar të të ardhurave nga taksat mjedisore.
- Vënë në funksion mekanizma të qartë të raportimit financiar dhe transparencës për të siguruar llogaridhënie në përdorimin e fondit të gjellbër.
- Prioritizuar investimet në energjinë e ripërtëritshme, eficiencën e energjisë, kontrollin e ndotjes dhe ruajtjen e biodiversitetit.

Baza ligjore për themelimin e Fondit të Gjellbër

Nga perspektiva ligjore, e vetmja mundësi e qëndrueshme për themelimin funksional të Fondit të Gjellbër në Kosovë është miratimi i një ligji të veçantë.

Në mënyrë specifike, neni 77, paragrafi 2 i Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit⁵ thekson se Fondi Ekologjik duhet të themelohet përmes një ligji të veçantë të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pa një akt të tillë ligjor të dedikuar, fondi nuk mund të operacionalizohet në mënyrë ligjore apo institucionale.

Kjo bazë ligjore nuk është vetëm një parakusht për funksionalitetin, por edhe një mjet strategjik për të:

- Përafruar arkitekturën e financimit të gjellbër të Kosovës me standardet e BE-së.
- Forcuar besimin e donatorëve dhe investitorëve;
- Mundësuar progres të matshëm në tranzicionin e gjellbër të vendit.

Rëndësia e Fondit të Gjellbër për Kosovën

Fondi i Gjellbër do të funksiononte si një mekanizëm i specializuar financimi, i krijuar në mënyrë të posaçme për të menaxhuar fondet e mbledhura nga taksat mjedisore dhe për t'i kanalizuar këto burime ekskluzivisht në iniciativë për qëndrueshmëri mjedisore. Fonde të tilla kanë dëshmuar sukses në vende të shumta, duke duke rritur qartësinë, llogaridhënien dhe besimin e publikut në qeverisjen mjedisore.

Rëndësia dhe Përfitimet e Fondit të Gjellbër

- Sigurimi i alokimit të dedikuar:

Fondi i Gjellbër garanton që të ardhurat nga taksat mjedisore të mbledhura të alokohen kryesisht për projekte mjedisore, duke reduktuar kështu rrezikun e shpërdorimit apo devijimit të tyre për shpenzime të panevojshme.

⁵ Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. (2009). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. E disponueshme në: https://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-025_en.pdf.

- Promovimi i qasjes gjithëpërfshirëse:

Fondi duhet të sigurojë që të paktën 30% e përfituesve të fondeve të jenë biznese të drejtuara nga gratë ose iniciativa nga të cilat përfitojnë drejtpërdrejt gratë dhe grupet e marginalizuara. Për më tepër, fondi do të ofrojë asistencë teknike dhe mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve për gratë sipërmarrëse dhe organizatat me bazë në komunitet.

- Transparenca dhe llogaridhënia:

Përmes një strukture të qartë qeverisjeje dhe mekanizmave të fuqishëm monitorimi, fondi do të mundësonte raportim gjithëpërfshirës të aktiviteteve financiare. Ky nivel transparence do të nxisë besimin tek qytetarët dhe palët e interesit, duke forcuar përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe mbështetjen e gjerë publike.

- Qëndrueshmëri afatgjate mjedisore:

Financimi i vazhdueshëm dhe i parashikueshëm mundëson planifikimin dhe zbatimin e projekteve afatgjate mjedisore, duke përfshirë iniciativat për energji të ripërtëritshme, programet për menaxhimin e mbeturinave, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ujit, ruajtjen e biodiversitetit dhe masat për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike si dhe dhe Kërkim dhe Zhvillim (R&Zh) në të gjitha këto projekte.

- Tërheqja e fondeve shtesë:

Fondi i Gjellbër i konsoliduar mund të mobilizojë burime shtesë financiare nga donatorët ndërkombëtarë, agjencitë zhvillimore dhe partneritetet me sektorin privat, duke rritur investimet në fushën e mjedisit dhe duke mbështetur qëllime më të gjera të qëndrueshmërisë.

Komponentët kryesorë për themelimin e Fondit të Gjellbër në Kosovë

Për të adresuar hendekun kritik ndërmjet mbledhjes së taksave mjedisore dhe investimeve në mjedis, Kosova duhet me urgjencë të themelojë një Fond të Gjellbër të dedikuar për këtë qëllim. Ky fond të siguronte që të ardhurat e mbledhura nga taksat mjedisore të riinvestohen në mënyrë sistematike në mbrojtjen e mjedisit, në vend që të absorbohen në buxhetin e përgjithshëm të shtetit ku qëllimi i tyre shpesh dobësohet. Fondi i Gjellbër do të ofrojë strukturën e nevojshme për të përafruar flukset financiare me objektivat e qëndrueshmërisë së Kosovës.

Fondi i Gjellbër i Kosovës duhet të themelohet si një subjekt juridik i pavarur, në pronësi publike, me autonomi të plotë financiare, administrative dhe operative. Misioni i tij kryesor do të ishte të mbështeste tranzicionin e gjellbër të Kosovës duke financuar dhe zbatuar investime të qëndrueshme nga ana mjedisore në përputhje me:

- Objektivat kombëtare për klimën dhe zhvillimin.
- Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së.
- Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.

Fondi do ta zbatojë këtë mision duke mobilizuar dhe alokuar burime financiare - duke përfshirë të ardhurat nga taksat mjedisore, kontributet nga donatorët dhe financimet ndërkombëtare për klimën - përmes një serie thirrjesh publike të strukturuara, që do të jenë të hapura për një gamë të gjerë përfituesish:

- Institucionet e sektorit publik, për projektet që promovojnë qëndrueshmërinë mjedisore, duke përfshirë infrastrukturën e gjelbër, adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, ekonominë qarkore, mbrojtjen e biodiversitetit, reduktimin e mbeturinave dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve.
- Subjektet afariste, për të mbështetur inovacionin e gjelbër, iniciativat e ekonomisë qarkore, teknologjitë e prodhimit të pastër, kontrollin e ndotjes dhe tranzicionin drejt modeleve të biznesit me karbon të ulët.
- Organizatat joqeveritare (OJQ); për të forcuar rolin e shoqërisë civile në avokimin mjedisor, edukimin, qëndrueshmërinë ndaj klimës të udhëhequr nga komuniteti, restaurimin e ekosistemit dhe ndryshimin e sjelljes drejt qëndrueshmërisë, me përfshirjen gjinore si prioritet ndërsektorial në të gjitha aktivitetet.

Duhet të miratohet një qasje e financimit të përzier për të maksimizuar ndikimin e burimeve të Fondit. Duke nxjerrë mësim nga modele të suksesshme si Eko Sklad i Sllovenisë, Fondi i Gjelbër duhet të kombinojë grantet, kreditë e buta dhe subvencionet e synuara. Kjo qasje do t'ia mundësonte Fondit të mbështeste një gamë më të gjerë projektesh, të mobilizonte investimet e sektorit privat dhe të optimizonte përdorimin e burimeve të kufizuara publike.

Transparenca duhet të shërbejë si gurthemel i operacioneve të Fondit të Gjelbër. Raportimi i rregullt publik mbi burimet e të ardhurave, projektet e financuara dhe rezultatet e matshme mjedisore është thelbësor për të rikthyer besimin e qytetarëve në sistemin e taksave mjedisore. Transparenca do të sinjalizonte gjithashtu përkushtimin e Kosovës ndaj standardeve ndërkombëtare mjedisore dhe do të rriste besueshmërinë e saj në kërkimin e mbështetjes shtesë ndërkombëtare.

Planifikimi strategjik do të jetë kritik për suksesin e Fondit të Gjelbër. Prioritetet e financimit duhet të përafrohen ngushtë me sfidat më urgjente të Kosovës, duke përfshirë përmirësimin e cilësisë së ajrit, zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme, modernizimin e menaxhimit të mbeturinave, ekonominë qarkore dhe forcimin e qëndrueshmërisë ndaj klimës. Duke synuar këto fusha kyçe, Fondi mund të ofrojë rezultate të matshme mjedisore, të mbështesë shëndetin publik, të stimulojë rritjen ekonomike dhe ta pozicionojë Kosovën si lider rajonal në qeverisjen mjedisore. Është e rëndësishme të theksohet se planifikimi strategjik duhet të udhëhiqet nga të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe në vlerësimin e ndikimit gjinor për të siguruar që investimet mjedisore kontribuojnë në zvogëlimin e jo në përforcimin e pabarazive ekzistuese, por përkundrazi të avancojë agjendën për barazi gjinore.

Falënderime për kontribuuesit

Përgatitja e këtij dokumenti të politikave është bërë e mundur falë kontributit të çmuar dhe mendimeve të palëve kryesore të interesit nga sektorë të ndryshëm. Ekspertiza e tyre, përvoja në terren dhe përkushtimi për avancimin e praktikave të qëndrueshme kanë luajtur rol thelbësor në formësimin e rekomandimeve të paraqitura në këtë dokument. Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për organizatat e mëposhtme për pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin e konsultimit dhe hartimit:

Komuna e Gjakovës, Komuna e Prishtinës, Instituti për Politika Zhvillimore, KAMA - Shoqata e Kosovës për Marketing të Veshmbathjeve, AWESK - Shoqata e Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ESRA - Shoqata për Mjedisin dhe Përgjegjësinë Sociale, Instituti për Siguri Publike, INDEP, EGW - Ecoskowsomen, Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural, Klubi Rinor i Ferizajt, Izolimi Plast, Riciklimi i Qelqit në Kosovës.

Referencat:

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2009). Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Marrë nga https://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-025_en.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2019). Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/2019, 1 mars 2019. Marrë nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684&langid=2>

ATLAS (2025). Të hyrat nga taksat mjedisore dhe shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë (2019-2023, Instituti Atlas, bazuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, 2025.

Clean Energy Wire. (n.d.). Pyetje & përgjigje BE synon të rrisë konkurrueshmërinë përmes Marrëveshjes së Industrisë së Pastër. Marrë në prill 2024, nga <https://www.cleanenergywire.org/factsheets/qa-eu-aims-bolster-competitiveness-through-clean-industrial-deal>

Eko Sklad. (2022). *Raporti Vjetor i Fondit Publik Mjedisor për vitin 2021*. Marrë nga <https://www.ekosklad.si/>

Komisioni Evropian. (2024). Dokument pune i personelit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2024 Marrë në prill 2024, nga https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en

Eurostat. (2022). *Statistikat e taksave mjedisore - Të dhënat për vitin 2021*. Marrë nga https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Environmental_tax_statistics

Qeveria e Republikës së Kosovës. (n.d.). Koncepti për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030.

Ministria e Financave e Sllovenisë. (2022). *Raporti Vjetor i Financave Publike 2021*.